



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 13.06. 2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Xhelal Sveçla, Ismet Beqiri, Fadil Beka dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi, Drita Millaku

Deputetët të tjerë, pjesëmarrës në takim: Shemsi Syla,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 29.03.2018 dhe 30.03.2018;
3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018;
4. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 29.03.2018 dhe 30.03.2018.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018.

Kryetari, konsiderojmë që plani i punës i paraparë për këto muaj(janar-qershor...) në masën më të madhe është realizuar. Komisioni përgjatë kësaj periudhe ka realizuar gjithsej me mbledhjen e sotme dymbëdhjetë(12) mbledhje. Janë shqyrtuar dhe miratuar Projektligjet: Projektligji për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Projektligji për Infrastrukturën Kritike, projektligjet që janë lidhur me Agjendën Evropiane (Projektligjin për Azil dhe për të Huajt. Gjithashtu në Komision kanë raportuar ish- Ministri i Punëve të Brendshme, z.Flamur Sefaj dy(2) here, ndërsa Bejtush Gashi-Ministër aktual i MBP-së ka raportuar 1 herë. Po ashtu ka raportuar edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës(1herë), Komandanti i FSK-së(1 herë). Është diskutuar rreth situatës së sigurisë në vend në njërin nga takimet, po ashtu është shqyrtuar dhe diskutuar edhe për Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2017, është shqyrtuar edhe raporti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në aspektin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së ligjeve, Komisioni ka formuar grupin punues për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për IPK-në, grupi ka bërë një punë të mirë dhe shpresojmë që shpejt të përmbyllin këtë mbikëqyrje. Po ashtu është realizuar edhe vizita në terren në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Ndërsa sa i përket vizitave jashtë vendit, Komisioni ka marrë pjesë në takimin organizuar nga Asambleja parlamentare e NATO-s.

Çfarë ka mbetur pa u realizuar dhe që është e rëndësishme të bëhet është formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së FSK-së, takimi i përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian për adresimin e çështjeve të agjendës Evropiane.

Ndërsa sa i përket projektligjeve që janë paraparë, por nuk janë proceduar në Kuvend, nuk është në përgjegjësinë e Komisionit. Ndërsa pritet shpejt të vijë Projektligji për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, për të cilën do të kërkojmë një hulumtim parlamentar nga drejtoria kompetente e Kuvendit. Fjalën ua kaloi anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi, lidhur me çështjen e mos procedimit të projektligjeve në Kuvend, theksoi se ka pasur një mungesë të diskutimit dh konsultimit mes Qeverisë dhe Komisionit, sidomos me procedimin e projektligjin për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura. Ndërsa sa i përket punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, theksoi se është bërë një punë intensive dhe se grupi punues është në përgatitje të raportit i cili bashkë me rekomandimet do t procedohet në seancë. Po ashtu theksoi se nuk është bërë aq sa duhet sa i përket mbikëqyrjes së financave në kuadër të FSK-së, gjë e cila është potencuar edhe në raportin e progresit për vitin 2017, por në ditët në vijim do të shikohet edhe mundësia e formimit të grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Policinë e Kosovës.

Xhelal Sveçla, duke iu referuar punës së Komisionit dhe zhvillimeve në institucionet e sigurisë, theksoi se ka pasur shumë zhvillime dhe barra i ka taku Komisionit. Duke iu referuar planit të punës shtoi se ajo duhet të përmbushet pro që disa nga aktivitetet nuk janë realizuar, siç është vizita e punës në Aeroportin e Prishtinës, projektligji për transformimin e FSK-së në Forca të armatosura, raportimin Ministrin të FSK-së lidhur me transformimin e FSK-së, tryeza e punës me Avokatin e Popullit, vizitë punë në pikat e kalimit kufitar, pasi është planifikuar fillimi i bisedimeve me shtetin serb, prandaj kërkoi që puna të përshpejtohet.

Fatmir Xhelili, lidhur me diskutimet për planin punës, shtoi se këto diskutime janë për të parë sa është realizuara dhe jo për suksesin ose mos suksesin Komisionit. Po ashtu theksoi se në përgjithësi institucioneve që hynë në fushëveprimin e Komisionit u mungon mbikëqyrja nga komisioni, ndërsa duke iu referuar punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së, theksoi se ka qenë produktive dhe ka identifikuar çështjet kyçe të cilat do të adresohen përmes rekomandimeve të grupit punues dhe Komisionit, ku përgjatë punës është dalë nevoja për ndryshim plotësimin e ligjit si dhe aspekti i udhëzimeve administrative që duhet që jenë në përputhje me ligjin. Gjithashtu propozoi që të fillohet edhe mbikëqyrja Ligjit të Policisë dhe propozoi formimin grupit punues, por edhe formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore nga ana e FSK-së, duke shtuar që ka munguar edhe debat me institucionet që mbikëqyr Komisioni por edhe me Shoqërinë Civile por që në vazhdimësi do të punohet në këtë drejtim.

Xhelal Sveçla, lidhur me planin e punës, theksoi se duhet të bëhen disa modifikime për shkak të rrethanave dhe të shpejtohet.

Muharrem Nitaj, lidhur me planin e punës, theksoi se është një dokument që mund të plotësohet, ndërsa as a i përket punës së grupit punues për mbikëqyrjen e ligjit të IPK-së, theksoi se është zgjatur dhe duhet të përfundoj. Po ashtu propozoi që plani duhet të rishikohet dhe aktivitetet e planifikuara që nuk kanë përfunduar të kryhen si dhe të plotësohet me aktivitete shtesë dhe e konsideroi si të nevojshëm bashkëpunimin me Komisionin për AKI.

Rexhep Selimi, shtoi se plani i punës mund të rishikohet dhe duhet të bëhet, po ashtu theksoi e disa grupe punuese marrin më shumë kohë për shkak të specifikave të çështjes, ndërsa propozoi që formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e Ligjit të Policisë dhe shpenzimeve buxhetore të FSK-së, të formohet në sesionin vjeshtor dhe të vazhdohet me mbikëqyrje.

Ismet Beqiri, theksoi se puna e Komisionit reflekton edhe punën e Kuvendit, ndërsa sa i përket procedimit të projektligjit për transformimin e FSK-së, theksoi se kurdo që vjen në Komision dhe Kuvend do të ketë përkrahjen për tu proceduar.

Muharrem Nitaj, sa i përket punës së Kuvendit, theksoi se është zgjedhur kurs tjetër i punës, dhe po të krahasohet me legjislaturën e kaluar, në këtë legjislaturë ka numër më të madh të interpelancave dhe debateve parlamentare.

Zoran Mojsilović, sa i përket punës së Komisionit theksoi se ka punuar aq sa ka pasur nevojë sipas planit të punës. Edhe pse kanë qenë disa situata të jashtëzakonshme, përveç atyre situatave të befasishme besoj që edhe grupi punues e ka bërë punën e vet. Tutje theksoi se realizimi i planit të punës është i kënaqshëm, ndërsa për aktivitetet që nuk janë realizuar mund të bartën për sesionin vjeshtor. Po ashtu e vërej që disa koleg dëshirojnë që të shtyjnë tutje Projektligjin për transformimin e FSK-së, por nga vizita që është bërë në Asambleenë Parlamentare e NATO-së e dimë për porosinë e tyre dhe nuk janë të kënaqur që procesi është ngutur.

Xhelal Sveçla, nga diskutimet e bëra u kuptua që duhet të bëhet një rishikim i planit të punës në mënyrë që të riorganizohet për sesionin vjeshtor.

Kryetari, theksoi se çfarë është e rëndësishme të realizohet në këtë periudhë është takimi me Komisionin për Integritet Evropian si dhe formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore të FSK-së.

PËRFUNDIM

Pas diskutimeve u caktua që rishikimi i planit të bëhet në ditë në vijim ndërsa formimi i grupeve punues për mbikëqyrjen e Ligjit të Policisë ë Kosovës dh mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore për FSK-në, të bëhet në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme.

Kryetari, njoftoi për një ftesë e cila i është drejtuar nga ana e Kryetarit të Komisionit për Siguri dhe Mbrojtje të Parlamentit të Maqedonisë në bashkëpunim me RACVIAC, nga data 24-26 qershor 2018. Ftesa i është drejtuar Kryetarit por janë të ftuar ehe dy anëtar dhe një staf i Komisionit. Tutje kërkoi që të jepen propozimet për pjesëmarrje në këtë Konferencë për takimin e përvitshëm të anëtarëve të Komisioneve parlamentare për siguri dhe mbrojtje të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Pas diskutimeve u propozua që pjesëmarrës në këtë Konferencë të marrin pjesë: Kryetari-Haxhi Shala dhe anëtarët: Muharrem Nitaj dhe Xhelal Sveçla.

Kryetari tutje njoftoi për tryezën e organizuar nga DCAF me datë korrik, për mbikëqyrjen e Ligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve. Ndërsa për mbledhjen e radhës propozoi që të ftohet në Komision për të raportuar Koordinatorin nacional përgjegjës për implementimin e Strategjisë kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe Avokatin e Popullit lidhur me të njëjtën çështje. Gjithashtu theksoi që sipas ligjit, Këshilli i Sigurisë së Kosovës duhet të paraqet një raport për Komisionin, gjë e cila nuk është bërë në legjislaturën e kaluar

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala